



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 24 gusht 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratua analiza dhe vlerësimi i raportit vjetor të përputhshmërisë së shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për vitin 2025, nga Zyrtari i Përputhshmërisë.

U miratuan disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 238, datë 06.11.2016, “Mbi licencimin e shoqërisë “ORHER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.

Në kuadër të çështjeve të tjera, Bordi u informua mbi kërkesën e shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)” sh.a. për një saktësim në afatin e licencës së saj për prodhimin e energjisë elektrike nga TEC-et lundruese “Tigri 1” dhe “Tigri 3”, me vendndodhje në Triport, Vlorë.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.